



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3168/19 prot.

Datë 08/03/2024

V E N D I M

Nr. 257/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08/03/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 85/2024, datë 24.01.2024, Nr. 176/2024, datë 14.02.2024, për procedurën e prokurimit “*E Hapur*” me nr. REF- 85061-10-24-2023 me objekt: “*Rikonstruksion, modernizim i reparteve/ magazinave të HSH*”, me fond limit 37,138,483.26 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 14.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Hekurudha Shqiptare Sh.A.

Ankimues:

“SARDO” SHPK me NIPT K13120402Ë dhe adresë Lagjja “Apollonia”, Rruga “Jakov Mile”, Z. Kadastrale 8534, Nr. Pasurie 3/5-N12, Fier.

Autoriteti Kontraktor:

Hekurudha Shqiptare Sh.A, me adresë Rr. “Egnatia”, Lagjja nr.3, Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 24.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 85/2024, ku vendosi: [...]

1. *Të mos pranojë ankesat e paraqitura nga operatori ekonomik "SARDO" SHPK për procedurën e prokurimit "E Hapur" me nr. REF- 85061-10-24-2023 me objekt: "Rikonstruksion, modernizim i reparteve / magazinave të HSH", me fond limit 37,138,483.26 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 14.11.2023, nga autoriteti kontraktor, "Hekurudha Shqiptare" ShA.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e nenit 111, pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 25/10 prot., datë 08.02.2024, protokolluar me tonën nr. 3168/11 prot., datë 13.02.2024 autoriteti kontraktor, njofton se: *"Në lidhje Vendimin tuaj nr.85/2024 ju bëjmë me dije se Autoriteti kontraktor Hekurudha Shqiptare sha, ka anuluar procedurën e prokurimit me objekt Rikonstruksion, modernizim i reparteve / magazinave të HSH me nr. REF- 85061-10-24-2023 në sistemin e prokurimit elektronik. Gjithashtu, gjatë rishpalljes së kësaj procedure do të mbahen në konsideratë të gjitha përcaktimet e nenit 111, pika 3 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", si dhe të gjitha konstatimet e reflektuara në vendimin tuaj".*

I.3. Në datë 14.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 176/2024, ku vendosi: [...]

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "E Hapur" me nr. REF- 85061-10-24-2023 me objekt: "Rikonstruksion, modernizim i reparteve / magazinave të HSH", me fond limit 37,138,483.26 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 14.11.2023, nga autoriteti kontraktor, "Hekurudha Shqiptare" ShA.*
2. *Autoriteti kontraktor të mari masa dhe të publikojë "Formularin e Anulimit" të procedurës së prokurimit sipas konstatimeve në vendimin KPP 85/2024 datë 24.01.2024.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.4. Me shkresën nr. 25/12 prot., datë 01.03.2024, protokolluar me tonën nr. 3168/16 prot., datë 07.03.2024 autoriteti kontraktor, njofton se: *"Në lidhje Vendimin tuaj nr.176/2024 ju bëjmë me dije se Autoriteti kontraktor Hekurudha Shqiptare sha, ka anuluar procedurën e prokurimit me*

objekt: “Rikonstruksion, modernizim i reparteve / magazinave të HSH”, me nr. REF- 85061-10-24-2023 në sistemin e prokurimit elektronik. Gjithashtu, gjatë rishpalljes së kësaj procedure do të mbahen në konsideratë të gjitha përcaktimet e nenit 111, pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe të gjitha konstatimet e reflektuara në vendimin tuaj”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 25/12 prot., datë 01.03.2024, protokolluar me tonën nr. 3168/16 prot., datë 07.03.2024 autoriteti kontraktor, njofton se: *“Në lidhje Vendimin tuaj nr.176/2024 ju bëjmë me dije se Autoiteti kontraktor Hekurudha Shqipatre sha, ka anuluar procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion, modernizim i reparteve / magazinave të HSH”, me nr. REF- 85061-10-24-2023 në sistemin e prokurimit elektronik. Gjithashtu, gjatë rishpalljes së kësaj procedure do të mbahen në konsideratë të gjitha përcaktimet e nenit 111, pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe të gjitha konstatimet e reflektuara në vendimin tuaj”.*

II.1.1. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor e ka zbatuar plotësisht vendimin e KPP nr. 85/2024 datë 24.01.2024 dhe KPP 176/2024 datë 14.02.2024.

KPP, në pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr. 85/2024 datë 24.01.2024, e ka lejuar autoritetin kontraktor që të anulojë procedurën dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin e KPP nr. 85/2024 datë 24.01.2024.

Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se, procedura e prokurimit është anuluar dhe e publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 13 datë 04.03.2024 me arsyetimin se *“kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”.*

Ndërkohë, autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP, dokumentacion provues fizik të formularit të anulimit të procedurës sipas konstatimeve në vendimin KPP 85/2024 datë 24.01.2024.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E Hapur” me nr. REF- 85061-10-24-2023 me objekt: “Rikonstruksion, modernizim i reparteve / magazinave të HSH”, me fond limit 37,138,483.26 lekë (pa

TVSh), zhvilluar më datë 14.11.2023, nga autoriteti kontraktor, “Hekurudha Shqiptare” ShA.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

